- Presidenti i Republikës, Kryeministri, zv kryeministri, ministrat, ose zvministrat, Deputetet, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët e Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë e në atë të Apelit, Avokati i Popullit, Anëtari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Anëtarët e Enteve Rregullatore, (Këshilli i Mbikqyrjes i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zv/Guvernatorin; të konkurrencës, telekomunikacionit; energjisë; furnizimit me ujë; të sigurimeve; letrave me vlerë; mediave), Sekretarët e Përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar tjetër, në çdo institucion publik, që është të paktën i barazvlefshëm për nga pozicioni me drejtorët e përgjithshëm, titullarët e institucioneve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për zyrtarët e nivelit të mesëm drejtues sipas nenit 31, dhe për zyrtarët e parashikuar në nenin 32 të kreut të III, seksioni 2 të këtij ligji, ndalimi sipas pikës 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave në fushën e territorit dhe të juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë është një institucion i varësisë.

Kur zyrtari është në funksionin e kryetarit a të nënkryetarit të bashkisë, komunës ose të këshillit të qarkut, të anëtarit të këshillit përkatës ose është zyrtar i nivelit të lartë drejtues të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave privatë të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë, zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave, sipas rastit, me bashkinë, komunën ose këshillin e qarkut, ku zyrtari ushtron këto funksione. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë në kontratë është një institucion publik, në varësi të kësaj njësie (neni 21 pika 2 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e përcaktuara në nenin 21 pika 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin që në kuptim të këtij ligji janë **bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi, fëmijë në moshë madhorë, prindërit e zyrtarit të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es.**

Unë i nënshkruari _____, me cilësinë e përfaqësuesit të personit juridik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time personale se:

Jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të përcaktuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive si dhe të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Në përputhje me to deklaroj se asnjë zyrtar i përcaktuar në **Kreun III, Seksioni II** të Ligjit Nr. 9367, datë 7.4.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk zotëron interesa private në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me personin juridik që unë përfaqësoj.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv),
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 4.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;

b. Deklaratë për paraqitje oferte të pavaruar, sipas Shtojcës 1/1;

c. Deklaratën mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 4/1;

ç. Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;

d. Deklaratën mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 6;

dh. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

2.2 Për të provuar përmbushjen e kapaciteteve të mëposhtme, Ofertuesi duhet të dorëzojë:

1. Xhiroja mesatare vjetore e tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit në një vlerë një vlerë sa fondi limit e perllogaritur per lotin ne te cilin paraqet oferte .

2. Kopje të vertetuara të bilanceve të 2 viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit, të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse, të konfirmuara nga ky autoritet.

3. Vërtetim lëshuar nga pushteti vendor për shlyerjen e taksave e tarifave vendore parashikuara për vitin 2020.

2.3 Për kapacitetin teknik: Përvojë e suksesshme në ekzekutimin e të paktën:

2.3.1 Ofertuesit duhet të kenë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit, me vlerë 40 % të vlerës së fondit limit për lotin që paraqet oferte. Kjo e vertetuar me:

Kur ky shërbim është realizuar me institucione shtetërore, operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur kontratën e shërbimit, faturën tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara dhe/ose vërtetim të lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e sukseshëm të kësaj kontrate.

OSE

Kur ky shërbim është realizuar me subjekte private operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur kontratën e lidhur me subjektet private të shoqëruar me faturën përkatëse tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

(të plotësohet nga autoriteti kontraktor)

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të zotërojë një certifikatë ISO 9001:2008 (Për implementimin e Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë)

2.3.3 Liçensa profesionale të shoqërisë ku të përfshihen kategoritë:

Për lotin 1 “ Mbikqyrje e punimeve për objektin “Sistemim asfaltim rruga “Llapushaj”, Gramsh” **kategoritë e licensave :**

- N.P-1(Punime germimi e toke)

- N.P-4 (Rruge autostrada, ura , mbikalime , hekurudha etj)
- N.P-7 (Ujesjelles, kanalizime, vepra kullimi e vaditje)
- N.S.-5 (Impiante te sinjalistikes ndricuese te trafikut)
- N.S.-18 (Punime topogjeodezike,)

Për lotin 2 Mbikqyrje e punimeve për “Rikonstruksion i rrugës automobilistike Skënderbegas, Loti II ” **kategoritë e licensave :**

- N.P-1(Punime germimi e toke)
- N.P-4 (Rruge autostrada, ura , mbikalime , hekurudha etj)
- N.P-5 (Punime nentokesore ura e vepra arti)
- N.P-12 (Punime te inxhinjerise se mjedisit)
- N.S.-5 (Impiante te sinjalistikes ndricuese te trafikut)
- N.S-7(Barriera dhe mbrojtje rrugore)
- N.S.-18 (Punime topogjeodezike,)

Për lotin 3 Mbikqyrje e punimeve për objektin “Ndërtim linje ujësjellësi Fshati Skënderbegas si dhe linja e ujësjellësit lagjia Koçaj e Fshat Gramsh ” **kategoritë e licensave :**

- N.P-1(Punime germimi e toke)
- N.P-2(Ndertime civile dhe industriale)
- N.P-7 (Ujesjelles, kanalizime, vepra kullimi e vaditje)
- N.P-12 (Punime te inxhinjerise se mjedisit)
- N.S.-18 (Punime topogjeodezike)

Për lotin 4 Mbikqyrje e punimeve për objektin “Sistemim asfaltim lagjia “ish – Reparti Ushtarak”, Gramsh ” **kategoritë e licensave :**

- N.P-1(Punime germimi e toke)
- N.P-4 (Rruge autostrada, ura , mbikalime , hekurudha etj)
- N.P-5 (Punime nentokesore ura e vepra arti)
- N.P-7 (Ujesjelles, kanalizime, vepra kullimi e vaditje)
- N.S-2 (Impiante hidro-termosanitare dhe mirembajtje e tyre)
- N.S.-5 (Impiante te sinjalistikes ndricuese te trafikut)
- N.S.-18 (Punime topogjeodezike,)

Për lotin 5 Mbikqyrje e punimeve për objektin “Meremetim kanale kulluese e mbrojtje nga permbytjet Perroi i Axhensise ” **kategoritë e licensave :**

- N.P-1(Punime germimi e toke)
- N.P-7 (Ujesjelles, kanalizime, vepra kullimi e vaditje)
- N.S.-18 (Punime topogjeodezike)

Për lotin 6 Mbikqyrje e punimeve për objektin “Meremetim kanale kulluese e mbrojtje nga permbytjet fshati Pishaj ” **kategoritë e licensave :**

- N.P-1(Punime germimi e toke)
- N.P-7 (Ujesjelles, kanalizime, vepra kullimi e vaditje)
- N.S.-18 (Punime topogjeodezike)

Kandidati/Ofertuesi i huaj duhet te ekuivalente(njesoje),licensen profesionale qe disponon,te leshuar nga vendi i origjines,prane Ministrise se Puneve Publike dhe Transportit.

2.2.4 Kandidati/ofertuesi duhet të ketë të punësuar dhe te perfshire ne licensen e shoqerise për ekzekutimin e kësaj kontrate(per 6 lotet)

- | | |
|--------------------------|---------|
| 1. Inxhinier ndertimi | 1 (nje) |
| 2. Inxhinier hidroteknik | 1 (nje) |
| 3. Inxhinier gjeodet | 1 (nje) |

Për inxhinierat e mesiperm, pika 2.2.4, pjese e stafit te cilet duhet detyrimisht te jene te pasqyruar ne listepagesat e shoqerise per te periudhen tre muajt e fundit nga data e zhvillimit te tenderit duhet të paraqitet kontratë noteriale pune (me kohe te plote) me afat vlefshmerie brenda afatit të zbatimit të kontrates për këtë objekt si edhe diplomë , CV + libreza pune.

2.2.5 Oferta ekonomike duhet të jetë në perputhje me Vendimit nr.354, datë 11.05.2016, të Këshillit të Ministrave,“Për miratimin e manulait të tarifave për shërbime në planifikim territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”. (per 6 lotet)

Vlerat e objekteve :

1. “Sistemim asfaltim rruga “Llapushaj”, Gramsh” - Fondi limit 81 666 600 (tetëdhjetë e një milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind) leke , pa TVSH.
2. “Rikonstruksion i rrugës automobilistike Skënderbegas, Loti II”- Fondi limit : 81 666 555 (tetëdhjetë e një milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e pesë)lekë, pa TVSH
3. “Ndërtim linje ujësjellësi Fshati Skënderbegas si dhe linja e ujësjellësit lagjia Koçaj e Fshat Gramsh” - Fondi limit: 19 166 638 (nëntëmbëdhjetë milionë e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtëmijë e gjashtëqind e tridhjetë e tetë) lekë, pa TVSH.
4. “Sistemim asfaltim lagjia “ish – Reparti Ushtarak”, Gramsh” - Fondi limit: 20 171 589 (njëzetë milionë e njëqind e shtatëdhjetë e një mijë e pesëqind e tetëdhjetë e nëntë)lekë, pa TVSH.
5. “Meremetim kanale kulluese e mbrojtje nga permbytjet Perroi i Axhensise” - Fondi limit : 1 274 295 (një milionë e dyqind e shtatëdhjetë e katër mijë e dyqind e nëntëdhjetë e pesë) lekë, pa TVSH
6. “Meremetim kanale kulluese e mbrojtje nga permbytjet fshati Pishaj” – Fondi limit : 1 106 188 (një milionë e njëqind e gjashtëmijë e njëqind e tetëdhjetë e tetë) lekë, pa TVSH

Te dhenat e objekteve per te cilat do te kryhet prokurimi i mbikqyrjes se tyre , jane te publikuara ne faqen zyrtare te APP_se

(të plotësohet nga autoriteti kontraktor)

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 8

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Specifikimi i Materialeve, Skicimet, parametrat teknik etj:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në marrëveshjen kuadër]

**PLANIFIKIMI I
KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

<input type="checkbox"/> Shërbim: Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër _____		
Kontrata Nr.	Titulli i Kontratës	Përshkrim i shkurtër i kontratës
01	_____	_____
02	_____	_____
03	_____	_____
...	_____	_____

Shtojca 10

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet:

Afatet e ekzekutimit:

Shtojca 11

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

TERMAT E REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

Për këtë i kërkohet mbikëqyrësit të punimeve të kësaj kontrate, të kryejë mbikëqyrjen e këtij objekti me fondin limit të mbikëqyrjes të llogaritur sipas vendimit të Këshillit të Ministrave Nr 354 dt. 11.05.2016 etj.ndryshime: **“Per Miratimin e Manualit te Tarifave per Sherbime ne Planifikim Teritori, Projektim, Mbikqyrje dhe Kolaudim”** Vlera e Dokumentat Standarde të Tenderit

II - OBJEKTIVI KRYESOR

Mbikëqyrësi i punimeve të zbatimit të punimeve për objektin ka për qëllim të kontrolloj dhe të ndjek mbarëvajtjen e gjithë procesit të zbatimit të punimeve në përputhje me projektin, kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike si dhe destinacionin e objektit duke patur parasysh afatin kohor të përcaktuar për kryerjen e punimeve të këtij objekti (afati kohor) dhe anën ekonomike të këtij objekti (vlehtë e kontratës).

III - DETYRAT, PËRGJEGJËSITË DHE TË DREJTAT E MBIKËQYRËSIT

Në realizimin e objektivave për zbatimin e punimeve të objektit:

“Mbikqyrje e punimeve për objektet që do të prokurohen gjatë vitit 2021”

Mbikëqyrësi menjëherë mbas lidhjes së kontratës duhet :

I. Të mbikëqyrë Kontratën e zbatimit të punimeve në emër të Bashkise Gramsh dhe të kryejë të gjitha detyrimet e besuara atij sipas Kontratës së nënshkruar, dhe sipas Ligjit Nr.8402 date 10.09.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit” në mbështetje të Udhezimit te KM Nr 3 date 15.02.2001 për “Mbikqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve te Ndertimit” i azhornuar me Udhezim I KM Nr 4 dt 17.05.2001, Udhezimi i KM, Nr 7 dat 21.11.2001, Udhezim i KM Nr 1 dt 22.02.2005 dhe Udhezim Nr 1. date 16.06.2011, etj qe jane ne fuqi sipas legjislacionit

II. Të njihet në detaj me projekt zbatimin dhe specifikimet teknike të objektit, të hartoj programin e kontrollit për zbatimin e projektit dhe cilësisë së punimeve në bazë të standarteve të përcaktuara me ligj.

III. Të paraqesë pranë Bashkise Gramsh stafin e tij mbikqyrës në përbërje të së cilit duhet të ketë;

1. Drejtuesin e punimeve, që duhet të jete inxhinier ndërtimi me eksperience pune në mbikqyrje i cili mban përgjegjësi për zbatimin e projektit sipas kushteve teknike të zbatimit, miratimin e volumeve të punimeve, certifikatën e pagesës, mbajtjen, kontrollin dhe miratimin e gjithë dokumentacionit, miratimin e ndryshimeve të volumeve, korespondencën me Bashkinë Gramsh.

2. Mbikqyrësin për punimet hidroteknike që duhet të jetë inxhinier hidroteknik me eksperiencë pune i cili kontrollon dhe miraton punimet hidroteknike në objekt.

3. Mbikqyrësin për punimet topografike që duhet të jetë inxhinier topograf me eksperiencë pune i cili kontrollon dhe miraton volumet, piketimet dhe kuotëzimin e

objektit.

Shënim : Në bazë të volumit të punimeve dhe vleftës së kontratës drejtuesi i punimeve duhet të jetë rezident në objekt dhe stafi tjetër mbikëqyrës mund të jetë rezident çdo ditë në objekt ose me kohë të pjesshme ne funksion te specifikave te punes.

Mbikëqyrësi i punimeve dhe stafi i tij kontraktin me Bashkinë Gramsh, duke përcaktuar detyrimet e ndërsjellta ,kushtet e punës,shpërblimin dhe probleme të tjera etj.

Mbikëqyrësi vihet në dijeni nga Bashkia Gramsh për nënkontraktorët e mundshëm që zgjedh sipërmarrësi në përputhje me kontratën e nënshkruar.

Mbikëqyrësi në fillim të punimeve në objekt merr kontakt me organet qeverisëse në juridiksionin e të cilit ndodhet zona ku kryhet ky objekt dhe informon për personat kryesor, përgjegjës për ndërtimin e këtij objekti,në përputhje me nenin 9,të ligjit Nr 8402 ,dt 10.09.1998

1.

Mbikëqyrësi ka për detyrë :

Të bëjë verifikimin e të gjithë dokumentacionit përkatës,të licencave të autorizimeve dhe të lejeve të cilat,sipas dispozitave në fuqi duhet të merren para fillimit të punimeve .

Të bëjë verifikimin e sheshit të ndërtimit,nëse është i lirë dhe i gatshëm për të filluar punimet.

Të njihet me hollësi me kontratën e sipërmarrësit dhe të gjithë akteve administrative që lidhen me të si dhe njohjen e të gjitha ndryshimeve të mundshme të kësaj kontrate me kalimin e kohës

Të kontrollojë vendosjen e tabelës së identifikimit të objektit :

Emërtimi i objektit:

Data e marrjes së lejes së ndërtimit -----

Investitori -----

Projektuesi -----

Sipërmarrësi dhe drejtuesi teknik “ -----“ shpk

Mbikëqyrësi-----

Afati I ndërtimit të objektit _____

Vlefta e objektit ----- lek (me TVSH)

Të marrë masat e duhura për sigurinë e objektit duke kontrolluar vendosjen në objekt të tabelave përkatëse sinjalizuese,treguese,e të sigurisë,shiritave, fenereve etj .sipas dokumentacionit të vlerësimit të rrezikut udhëzimi nr 312 dt 05.05.2010 të këshillit të ministrave “Për miratimin e rregullores për sigurimin në kantier i quajtur plani i sigurisë dhe koordinimit (PSK)

Mbas verifikimit të dokumentacionit duhet të dorëzojë pranë Bashkisë Gramsh të gjithë dokumentacionin si dhe shkresën për fillimin e punimeve ku përfshihen

Stafi i Sipërmarrësit

Makineritë që do përdoren për ndërtimin e objektit.

Laborator i licensuar që do të kryhej testet e materialeve

Para fillimit të punimeve verifikon të gjitha pajisjet dhe makineritë e sipërmarrësit, për të parë nëse ato i përgjigjen kushteve të kontratës së nënshkruar.

Të kontrollojë zbatimin projektin duke u bazuar në projekt zbatimin dhe specifikimet

teknike dhe të propozojë modifikimet, plotësimet dhe mospërputhjet nëse ka dhe ti propozojë BD-së zgjidhjet konkrete.

Të ndjek në mënyrë të vazhdueshme e të kualifikuar të gjitha proceset e punimeve dhe dokumentacioneve që duhen të mbahen gjatë zbatimit të punimeve, miratimin e analizave të veçanta, duke dhënë udhëzime, porosi e urdhëra për zbatimin me përpikmëri e në kohë të projektit, të kushteve teknike të projektimit dhe zbatimit, të dispozitave përkatëse të kontratave.

Të kërkoj të zbatoj në mënyrë korrekte plan –organizimin e punimeve .

Të kërkoj dhe të zbatoj lejen (autorizimin, pëlqimin) mjedisore, të miratuara nga organi kompetent.

Të kontrolloj në mënyrë korrekte dhe të vazhdueshme pikëtimin e objektit, kuotat e trashësitë e shtresave, kuotat e vendosjes së veprave të artit.

Të respektoj dokumentacionin përkatës kur objekti ndërtohet në zonat turistike, arkeologjike apo të trashëgimisë kulturore .

Të kontrolloj bazamentin e objektit dhe të japë miratimin e tij për vazhdim të punimeve

Të kontrolloj çdo material që vendoset në vepër, mënyrën e vendosjes së tij dhe cilësinë e tij .

Për çdo punim të maskuar të bëjë fotografimin ose regjistrim e tij dhe të mbaj proces verbal të firmosur prej tij dhe sipërmarrësit . (formati tip sipas udhëzimit Nr 1 dt 16.06.2011, Për disa ndryshime në udhëzimin Nr 3 dt 15.02.2001 të këshillit të ministrave për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit të ndryshuar)

Në çdo fund ditë pune të kontrolloj ditarin e punimeve dhe të firmos atë . (formati tip sipas udhëzimit Nr 1 dt 16.06.2011, Për disa ndryshime në udhëzimin Nr 3 dt 15.02.2001 të këshillit të ministrave për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit të ndryshuar)

Të kontrolloj situacionet e paraqitura nga sipërmarrësi në fazat e ndryshme të punimeve dhe mirratoj ato. (formati tip sipas udhëzimit Nr 1 dt 16.06.2011, Për disa ndryshime në udhëzimin Nr 3 dt 15.02.2001 të këshillit të ministrave për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit të ndryshuar)

Të kontrolloj librin e masave ku pasqyrohen vëllimet metrike gradualisht me zhvillimet e tyre (formati tip sipas udhëzimit Nr 1 dt 16.06.2011, Për disa ndryshime në udhëzimin Nr 3 dt 15.02.2001 të këshillit të ministrave për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit të ndryshuar) cili vërteton volumnin e punimeve dhe ta miratoj atë.

Të kontrolloj certifikatat e cilësisë së materialeve dhe të jap miratimin për vendosjen në objekt të tyre

Gjatë zbatimit të projektit, i jep instruksione me shkrim sipërmarrësit, sa herë që e sheh të nevojshme, dhe sipërmarrësi është i detyruar t'i zbatojë ato. Ky i fundit ka të drejtë të bëjë me shkrim vërejtjet e tij lidhur me instruksionet dhe urdhërat e marrë.

Për çdo rast, që gjatë zbatimit të punimeve lind nevoja e ndryshimeve në Projektin dhe Preventivin e parashikuar, Mbikëqyrësi i Punimeve duhet t'i paraqesë Bashkisë Gramsh një relacion të plotë teknik (shoqëruar me skicat përkatëse) ku argumentohet ndryshimi. ***Ndryshimi në objekt (zbatimi i punimeve) do të bëhet vetëm pas miratimit nga Bashkia Gramsh***

Të nenshkruaj aktin përfundimtar të kontrollit të punimeve për faza të ndryshme .

Në çdo fund muaji mbikëqyrësi ka për detyrë të paraqes pranë Bashkisë Gramsh raport mujor

të punimeve. Në këtë raport duhet të jepet një tablo e qartë e avancimit të punimeve dhe të pagesave të kryera. Realizimi i punimeve në vleftë dhe % , afati kohor realizimi i financimit.

Raporti Mujor do të ketë këtë përmbajtje:

- Hyrje
- Informacion i përgjithshëm
- Të përgjithshme
- Qëllimi i punimeve
- Të përgjithshme
- Mbikëqyrja e punimeve ndërtimore
- Personeli i siguruar nga Mbikëqyrësi
- Staf i nevojshëm në përputhje me kontratën e zbatimit të punimeve.
- Staf aktual
- Kohëqëndrimi në objekt për secilin.
- Raportimi
- Kohëzgjatje e shërbimit të Mbikëqyrjes
- Përshkrimi i Projektit
- Shtresat Rrugore
- Veprat e Artit etj.
- Organizimi i Sipërmarrësit
- Sipërmarrësi
- Staf present
- Mjete dhe makineri
- Kohëqëndrimi në objekt
- Progresi Mujor
- Përshkrim të Punimeve që janë kryer gjatë muajit (sipas zërave dhe piketave)
- Fotografji të proceseve të punëve të kryera
- Fotografji të punimeve të maskuara për çdo punim të padukshëm
- Grafiku i ecurisë së punimeve
- Të aprovuara
- Të kryera
- Volumet Progressive të Punimeve Mujore
- a) Punimet e Aprovuara
- b) Çertifikatat e cilësisë dhe testet Laboratorike
- c) Libreza e Masave
- d) Punimet e Kryera por të pa aprovuara
- e) Situacionet mujore
- f) Matjet topografike
- g) Korespondenca
- a-Proces-Verbale
- b-Urdhëra, Udhëzime, Njoftime
- c-Ndryshime në Projekt dhe Preventiv në se ka (të aprovuara nga Bashkia Durrës)
- Moti (kalendarik)
- Problemet që kanë dalë
- a) Teknike
- b) Sociale
- Konkluzione

Shënim : Raporti Mujo dhe dokumentat duhet të paraqiten në gjuhën shqipe, në pese kopje dhe tre kopje të dorëzohet në Bashkinë Gramsh pranë Drejtorisë së Planifikim Territorit do t'i dorëzohet Bashkisë Gramsh brenda datës të caktuar në kontratë. Konsulenti do të mbajë kontakte të vazhdueshme me Bashkinë Gramsh (Drejtorisë së Planifikim Territorit) dhe dot'i përgjigjet të gjitha kërkesave të saj.

Mbikëqyrësi mban përgjegjësi të plotë ;

- Mbikëqyrësi i punimeve është një nga përgjegjësit kryesor për ndërtimin e objektit
- Në fillim të punimeve mbikëqyrësi mban dhe ka përgjegjësi për dokumentacionin e objektit :
- Vendimin për sheshin e ndërtimit dhe lejen origjinale të ndërtimit.
- Projektzbatimin e firmosur nga projektuesi dhe investitori sëbashku me specifikimet teknike .
- Dokumentacionin topografik dhe gjeologo-inxhinierik të bazamentit (ne se ka, si dhe cdo dokumentacion the nevojshem) ku do të kryhen punimet .
- Realizimin e punimeve të objektit sipas projektit kushteve teknike të zbatimit në fuqi dhe specifikimeve teknike
- Saktësinë ,vërtetësinë e dokumenteve volumet dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit.
- Për realizimin pikë për pikë të kontratës së nënshkruar midis Sipërmarësit dhe Bashkisë Gramsh, për realizimin e të gjithë fazave të zbatimit të punimeve, respektimit të afatit të dorëzimit si dhe të kostos së objektit.
- Asnjë punim nuk do të mbulohet,maskohet apo betonohet pa miratimin e mbikëqyrësit. Sipërmarësi duhet të njoftojë mbikëqyrësin kur është gati për t'u ekzaminuar prej tij .
- Ruajtjen e të gjithë dokumentacionit dhe korespondencën me Bashkinë Gramsh,urdhërat e ndryshme që ai ka dhënë gjatë zbatimit të kontratës,kundërshtitë dhe kontradiktat e lindura gjatë punës,ndërprerjet e punimeve dhe shkaqet që e kanë diktuar këto ndërprerje,relacionet teknike të kërkuara ose të paraqitura gjatë zbatimit si dhe të gjitha rrethanat e nevojshme për të dhënë kuadrin e plotë të të gjithë fazave të zbatimit të punimeve .
- Për dorëzimin e gjithë dokumentacionit që disponon në rast së gjatë zbatimit të kontratës kemi ndërmir të mbikëqyrësit.I gjithë dokumentacioni dorëzohet me proces verbal ku shënohen dhe shkaqet e këtij ndërmir,investitori kontrollon praninë e mbikëqyrësit të punimeve në objekt dhe ne rast konstatimi të mungesës së tij,nxjerrin vendimin për pezullimin e punimeve deri në emërtimin dhe praninë e tijne object.

Mbikëqyrësi ka të drejtë :

1. Të kërkojë largimin nga puna të drejtuesit të kantierit ose të punëtorëve të veçantë për mosbindje, paaftësi ose pakujdesi të rëndë.
2. Të mos pranojë drejtues,teknik,manovrator,punëtor n.q.s këta nuk plotësojnë kushtet për të kryer detyrën e caktuar.
3. Të pezullojë punimet kur sheh se në objekt nuk janë marrë masat e duhura për të siguruar punimet dhe trafikun.
4. Të mos lejoj vendosjen në vepër të materialeve që nuk plotësojnë kushtet e cilësisë dhe ti zëvendësoj ato me materiale të tjera nga sipërmarësi me shpenzimet e tij.
5. Të kërkojë certifikatat e cilësisë së pajisjeve që kryejnë testet e materiale
6. Të kërkojë dhe të asistojë në kryerjen e provave të materialeve, për të verifikuar cilësinë e tyre. Shpenzimet për këto prova janë në ngarkim të sipërmarësit.

7. Të kërkojë për të gjitha makineritë që punojnë në vepër dokumentacionet teknike për të siguruar një ecuri punimesh të sigurta dhe cilësore.
8. Të mos lejoj përdorimin e makinerive dhe pajisjeve të ndryshme n.q.s ato janë jashtë kushteve teknike .
9. Në rast se materialet dhe pajisjet e përdorura nuk miratohen nga mbikëqyrësi këto duhet të dokumentohen me procesverbalet e analizave të provave sëbashku me aktin teknik,ku të argumentohen shmangiet palejuara,referuar standarteve të përcaktuara në specifikimet teknike të projekt zbatimit.
10. Të kërkojë kryerjen e provave shtesë për materialet e vendosura në objekt,ku këto nuk janë kryer në masën sipas vëllimeve të realizuara dhe pjesë së lëndës së parë të furnizuar për të verifikuar cilësinë. Shpenzimet për këto prova janë në ngarkim të sipërmarrësit.
11. Kur Mbikëqyrësi i Punimeve mendon se ka dëmtime në konstruksion, kërkon të bëhen verifikimet përkatëse. Kur verifikimet i japin të drejtë mbikëqyrësit, shpenzimet janë në ngarkim të sipërmarrësit. Në rast të kundërt, sipërmarrësi ka të drejtë të kërkojë shlyerjen e shpenzimeve.
12. Mbikëqyrësi i Punimeve urdhëron Sipërmarrësin të prishë dhe të ribëjë me shpenzimet e tij, punime të bëra jo me cilësinë e parashikuar në Projekt dhe Specifikimet Teknike.
13. Mbikëqyrësi i Punimeve ka të drejtë të pezullojë përkohësisht punimet, për ekzekutim teknik të gabuar ose paafësi teknike zbatimi, për çdo rast me miratimin e Bashkise Gramsh -së, për aq kohë sa ai e konsideron te arsyeshme. Në këtë rast sipas fajit, Mbikëqyrësi së bashku me Bashkise Gramsh dhe sipërmarrësin përcaktojnë zgjatjen ose jo të afatit dhe ndryshimin e shpenzimeve.

Në përfundim të punimeve mbikëqyrësi :

- Merr me shkrim njoftimin për përfundimin e punimeve dhe vërteton në proces verbal datën e përfundimit të tyre,sipas projektit, të ndryshimeve të urdhëruara e të kushteve të kontratës dhe brenda 30 ditëve mer prej tij dokumentacionin përkatës .
- Duke u mbështetur në Ligjin 8402 dt 10.09.1998 UKM Nr 2 datë 13.5.2005 dhe UKM Nr 3 datë 15.02.2001 i ndryshuar me udhëzimin Nr 1 dt 16.06.2011, etj dorëzon pranë Bashkise Gramsh (Drejtorisë së Planifikim Territorit) të gjithë dokumentacionin përkatës për të cilin mban përgjegjësi të plotë në plotësimin, saktësinë,vërtetësinë e tij.

Ky dokumentacion duhet të përmbajë :

1. Proces verbal i dorëzimit të sheshit të ndërtimit.
2. Proces verbal për fillimin e punimeve.
3. Kontratën e sipërmarrësit
4. Kontratën e mbikëqyrjes
5. Projekt organizimi i punimeve.
6. Projektin
7. Projektin e ndryshuar (nëse ka) shoqëruar me korespondencën skicat përkatëse dhe miratimet e nevojshme.
8. Preventivin. fitues
9. Preventivin e ndryshuar (nëse ka zërat të rinj të punimeve negocimin e tyre).
10. Grafiku i punimeve
11. Specifikimet teknike
12. Axhornimi para fillimit të punimeve dhe pikëtimi .

13. Dokumentacioni topografik dhe gjeologo inxhinjrik (ne se ka)
14. Dokumentacioni fotografik apo video regjistruesi për punimet e padukshme.
15. Proces-verbalet e çdo punimi të maskuar të firmosur nga drejtuesi teknik dhe mbikëqyrësi të shoqëruar me fotografi etj. Dokumentacion the nevojshem.
16. Ditari i objektit ku të pasqyrohen dhe ndryshimet e urdhëruara nga mbikëqyrësi.
17. Libreza e masave.
18. Çertifikatat e cilësisë së materialeve dhe testet laboratorike te materialeve te përdorur në objekt
19. Miratim i materialeve të përdorura nga mbikëqyrësi.
20. Situacionet pjesore dhe atë përfundimtar.
21. Regjistri i kontabilitetit.
22. Deklarata teknike e sipërmarësit e firmosur nga sipërmarësi dhe drejtuesi teknik.
23. Njoftimi i sipërmarësit për përfundimin e punimeve.
24. Proces verbal i përfundimit të punimeve të firmosur nga sipërmarësi dhe mbikëqyrësi së bashku me matjet faktike të objektit të ndërtuar.
25. Relacionin përfundimtar i mbikëqyrësit
(formatet tip te dokumentacionit te jene sipas formatit tip ne udhezimin Nr 1 dt 16.06.2011 per disa ndryshime ne udhezimin Nr 3 dt 15.02.2001 te keshillit te ministrave “Per mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve te ndertimit “ te ndryshuar)

I gjithë dokumentacioni duhet të ketë miratimin e tij .Ky dokumentacion është në 3 (tre) kopje .Një kopje e të gjithë dokumentacionit dorëzohet pranë grupit të kolaudimit që ngrihet me urdhër nga Autoritetit Kontraktor brenda 30 ditëve nga përfundimi i objektit .Të gjithë dokumentat që dorëzohen pranë Bashkise Gramsh, tek Grupit të Kolaudimit pranë Bashkise Gramsh duhet të jenë origjinale.

Mbikëqyrësi i Punimeve merr pjesë në Kolaudimin e objektit dhe i përgjigjet Grupit te Kolaudimit për të gjithë dokumentacionin e nevojshëm gjatë kolaudimit tëobjektit dhe firmos Proces-Verbalin e Kolaudimit.

Pas përfundimit të kolaudimit mbikëqyrësi i punimeve mbështetur në kontratën dhe në dokumentacionin tjetër,përcakton vlerën përfundimtare të objektit e cila i bëhet e ditur sipërmarrësit dhe i jepet për të likuiduar Autoritetit Kontraktor.

IV - KOHËZGJATJA E SHËRBIMIT TË MBIKËQYRJES

Do të jetë për gjithë periudhen e zbatimit të punimeve.

V –THE DREJTAT E AUTORITETIT KONTRAKTOR

Bashkia Durrës ka të drejtë të kërkojë largimin e mbikëqyrësit kur vërtetohet mangësi serioze në veprimtarinë e tij si :

- Mangësi në plotësimin e detyrave të përcaktuara. Ndërprerje e paarsyeshme e punimeve dhe zgjatje e theksuar e tyre .
- Mangësi kontrolli në kosto e kontabilitet,tolerim i materialeve me vlera mbi ato të preventivuara,tolerim të materialeve jashtë cilësisë së kërkuar, tolerim të punimeve jo me cilësinë e kërkuar,tolerim të pajisjeve jashtë kushteve teknike
- Kur vërehen shkelje të rënda të dispozitave ligjore, Bashkia Gramsh ka të drejtë të urdhëroj mbikëqyrësin e punimeve për ndërprerjen e punës deri në marrjen e masave përkatëse,për normalizimine gjendjes.
- Kur shkeljet e dispozitave ligjore mund të përbëjnë kundërvajtje administrative vendosen sanksione,në bazë të neneve 15 dhe 16 të kreut III të ligjit Nr 8402 dt 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve”

Shtojca 12

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR³

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” .

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme :

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi sic parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt
< **Emri** >

³ Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore.

Shtojca 13

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ numri i NIPT-it _____
Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ numri i NIPT-it _____
Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ numri i NIPT-it _____
2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ numri i NIPT-it _____

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra [_____]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 14

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____

2. _____

3. _____

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia, objekti, kohëzgjatja e kontratës etj]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____

(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it* _____

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it* _____

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it* _____

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it* _____

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

Etj.____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 15.

**KUSHTET E PËRGJITHSHME
Shërbimet–Kërkesë për propozim**

Neni 1: Qellimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e shërbimeve të prokuruar me anë të procedurës kërkesë për propozim.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë, gjithashtu, Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

